

Luan PËRZHITA

---

## VËSHTRIM MBI ORGANIZIMIN KISHTAR NË DARDANI GJATË PERIUDHËS MESJETARE

Në shekullin e IV si në të gjithë vendet e Evropës së asaj kohe, edhe në Dardani u pranua feja e re e kristianizmit. Një aktivitet i tillë plotësohet mjaft mirë jo vetëm nga burimet e kohës, të cilat flasin për një korespondencë të plotë me kishën e krishterë të asaj kohe, por dhe nga të dhënat arkeologjike.

Kërkimet e viteve të fundit në Kosovë, treguan se qendra e kësaj periudhe po përcjellin vlera shpesh herë unikale mbi urbanizimin e kësaj treve kryesisht gjatë sundimit të Justinianit dhe më pas në mesjetë. Disa monumente paleobizantine, qyteza apo fortifikime përbëjnë një lëndë me rëndësi për këtë epokë. Studimi i tyre sapo ka filluar të plotësojë një pamje të re mbi arkeologjinë dhe arkitekturën paleokristiane në Kosovë.

Panorama topografike e shtrirjes së monumenteve të periudhës paleokristiane u zgjerua së tepërmi si rezultat i kërkimeve arkeologjike, që u kryen në Kosovë<sup>1</sup>. Gjurmime arkeologjike treguan për një dendësi vendbanimesh të tipeve të ndryshëm, që ndodhën në rajonin që përfshin pellgun e Drinit të Bardhë si dhe të lumenjve të tjerë si Lumbardha e Pejës, lumin e Klinës, Erenikun e Gjakovës, Mirushën e Malishevës etj. Disa monumente paleobizantine, qyteza apo fortifikime përbëjnë një lëndë me rëndësi për këtë epokë.

---

<sup>1</sup> L. Përzhita, K. Luci, G. Hoxha, A. Bungri, F. Peja, T. Kastrati, Harta Arkeologjike e Kosovës I, Prishtinë 2006.

Duhet të theksojmë se gjurmimi i kishave të hershme në Kosovë gjatë dekatave të fundit është anashkaluar. Aktiviteti kryesor në këtë fushë ka qenë drejtuar vetëm në kishat e periudhës së shekujve XIV dhe më vonë. Është me mjaft rëndësi të përmendim zbulimet e bëra më parë në fushën e arkitekturës paleokristiane si dhe një sërë rezultatesh të reja që janë arritur gjatë viteve të fundit në Kosovë.

Gërmimet e reja arkeologjike në qytezën e fortifikuar të Korishës (Prizren)<sup>2</sup>, Harillaqit (Fushë-Kosovë)<sup>3</sup>, Kastercit (Suharekë)<sup>4</sup>, kanë sqaruar përveç sistemit fortifikues dhe një kishë të periudhës paleokristiane, duke e vendosur këtë qytezë në grupin e monumenteve të shekullit VI në Dardani.

Ndërtimi i një serë objektsh kulti në territorin tashmë të hulumtuar siç janë ato të Vërmicës, Banja afër Pejës, apo gjurmë të një apside të zbuluara gjatë hapjes së rrugës Pejë–Banjë, të cilat datohen në shekujt IV-V<sup>5</sup>. Po ashtu, kisha e Bela Cerkves dhe ajo e Studenicës janë ngritur mbi struktura më të hershme të cilat datohet në shekullin e VI. Këtij grupi i shtohet dhe kisha e shën Angjelit në Prizren, e cila ndonëse e datuar në shekujt X, nga skulptura dekorative dhe fragmentet arkitektonike mund të datohet në periudhën paleokristiane<sup>6</sup>.

Qendra kishtare e dardanëve del në dokumentacionin historik në vitin 325 me kryeqendër Shkupin. Dokumenti i parë i shkruar që flet për organizimin e kristianizmit në provincën e Dardanisë, është ai i Konsilit të Parë, organizuar nga perandori Konstandin në vitin 325 pas Kr., ku përmendet emri i peshkopit të metropolit të Dardanisë<sup>7</sup>. Megjithatë burime të ndryshme flasin se territori dardan kishte përfaqëuar shumë më herët idetë e kristianizmit. Një tregues mjaftë sinjifikativ për këtë është përmendja e martirëve dardanë, *Florit* dhe *Laurit*, të cilët kanë zhvilluar

<sup>2</sup> G. Hoxha, *Mbi gërmimet arkeologjike në kishën palokristiane të fshatit Korishë (21 maj-12 qershor 2004, Kosova Arkeologjike 1-2005, Prishtinë 2006, f. 167-173.*

<sup>3</sup> F. Peja, A. Hajdari, *The fortress of Harillaq, L'Ilyrie Méridionale et l'Épire dans l'antiquité V, Actes du IV Colloque International de Grenoble (10-12 octobre, 2008) volume II, Paris, p.479-482.*

<sup>4</sup> L. Përzhitë, G.Hoxha, *Fortifikimet e shekujve IV-VI në Dardanië Perëndimore, Tiranë 2003.*

<sup>5</sup> Z. Mirdita, *Krishtenizmi nder shqiptaret, Zagreb 1998; G. Gjini, Ipeshkvia Shkup – Prizren nëpër shekuj, Zagreb 1992.*

<sup>6</sup> G. Gjini, *Ipeshkvia Shkup – Prizren nëpër shekuj..., f. 26.*

<sup>7</sup> E. Honigman, *Recherches sur les listes des Pères de Nicés et de Constantinople, Byzantion 11, 1936, p. 442*

aktivitetin e tyre në Dardani në mesin e shekullit të II pas Kr. Në *Acta Sanctorum* përmendet atdheu i martitëve që është Dardania si dhe vendi i martirizimit Ulpiana. Po ashtu rezulton se në Konsilin e Nicës, ishte dhe peshkopi i Dardanëve « *Dacus Dardaniae* »<sup>8</sup>.

Një qendër tjetër, me rëndësi për zhvillimin e fesë së krishterë në Dardani, përveç Scupit, paraqitet Ulpiana, e cila në shekullin e IV dokumentohet në rangun e një selie peshkopale. Në organizimin e saj Dardania përgjatë shekujve IV dhe V ka patur disa dioqeza si në *Scup, Ulpianë, Neutina, Diokletiana, Mariana, Justiniana Prima, Stobi* etj. Sipas dokumentacionit historik të kohës gjatë viteve 552-559 shpërthyen në Dardani revolta të mëdha fetare në qytetin e Ulpianës, për shkak të vendimit të “*Tria Capitula*”<sup>9</sup>. Një fenomen i tillë në atë periudhë lidhet me mospajtueshmërinë e drejtuesve të fesë dardane me vendimin e Papa Virgjilit. Kjo me sa duket shpreh në rradhë të parë krijimin e strukturave të qëndrueshme të fesë kristiane dardane dhe politikën e saj me rëndësi që kishte ajo në hierarkinë në përgjithësi, pasi siç tashmë dihet, ato nuk nënshkruan në konsilin që mbajti Papa Virgjili për dënimin e “*Tria Capitula*”. Por, ky dokument ka një rëndësi të mëdhe pasi aty përmendet i gjithë Peshkopata e Dardanisë dhe shënohen përfaqësuesit nga Dardania si argjipeshkvi i Justinianës së Parë, *Benenatin; Sabini* nga Zapara, profekti nga Naissusi dhe peshkopi i Justiniana Secundës, *Pali* etj. Njëkohësisht janë përmbledhur të gjithë letrat e ruajtura për Kishën Dardane siç janë ato të Papës Celestinit të I-rë, Inoçenti I (v. 414), Gelazit të I (v. 493), Simaku (v. 513), Gërgurit të Madh (v.592) apo të perandorëve<sup>10</sup>.

Në novelën e dytë CXXXI (v.545)<sup>11</sup> perandori me origjinë dardane i Bizantit, Justiniani rregulloi statusin e arkipeshkvit dhe të vikariatit të Justiniana Primës. Njëkohësisht këtu shënohet edhe korespondenca e bërë nga peshkopët dardanë, veçanërisht perandori Leoni I August nënshkruar nga peshkopi Ursili, Dalmati dhe Maksimi, apo letra tjetër drejtuar papa Gelazit etj.

Prania e kishës, e cila ishte e lidhur me popullsinë autoktone të krishtere, dëshmon se Dardania nuk i sllavizua nga paganet e stepave. Në vitin 787 peshkopët e Dardanisë morën pjesë në koncilin e Nikesë, ndërsa perandori bizantin Leoni III (717-741) vuri nën vartësinë e patriakut të Kostandinopojës edhe peshkopatën e

<sup>8</sup> G. Gjini, *Ipeshkvia*.... f. 27.

<sup>9</sup> Po aty..., f.35.

<sup>10</sup> D. Cuhlev, *Istorija na Blgarskata Crkva (864-1186) I*, Sofija 1911,128,171; A. Bačkallov, *The Early Middle Ages, The archeological treasures of Kosovo and Metohija*, Beograd 1998, p. 376.

<sup>11</sup> E.Golubinjskij, *Kratkij očerk istorija Južnih Slovena*, ZRVI 2, 1953 p, 52-61.

Justiniana Primës<sup>12</sup>. Peshkopata e Shkupit na del përsëri në dritën e dokumentave të vitit 864, në të cilin prijësi bullgar, Borisi, u pagëzua si i krishterë në kishën e Ballshit së bashku me popullin e vet. Kjo dëshmon se banorët e Dardanisë jugore nuk ishin sllavë, por i përkisnin popullsisë autoktone dardane.

Konvertimi i popullsisë iliro-dardane në të krishterë përkoi me dy valët e mëdha të dyndjeve barbare nëpër trevat e tyre në Ballkanin Perëndimor. Vitet 700-850 shënojnë fillimin e procesit të ndryshimeve ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit. Dy shekujt e parë pas ardhjes së sllavëve në territorin e Dardanisë janë të errët dhe plot paqartësi, jo vetëm për historinë por veçanërisht për rrethanat kishtarë.

Gjatë shekullit IX-XII, sllavët vendosën në Ballkan dhe kryen procesin e gjatë të kristianizimit të tyre. Mungesa e materialit historik ka krijuar vështësi në lidhje me sqarimin e situatës për këtë periudhë pasi ajo është e shoqëruar dhe me mungesën e të dhënave kishtarë të Perandorisë Bullgare për shekullin e IX. Me ardhjes e sllavëve pa dyshim u shkatërrua rëndë jeta kishtarë që kishte lulëzuar deri në atë kohë. Për një kohë u shkëputën të gjitha lidhjet me Romën si dhe me qytetet e tjera të bregdetit. Një informacion tjetër thotë se Scupi ka vazhduar deri në fund të shekullit VIII pasi një ipeshk dardan ka marrë pjesë në Konsilin VII Ekumenik të vitit 787<sup>13</sup>. Gjatë sundimit të Leonit III, 717-741, vërejmë se peshkopata e Justiniana Primës ishte në vartësi të Konstandinopolit. Në vitin 787 peshkopët e Dardanisë morën pjesë në koncilin e Nikesë, ndërsa perandori bizantin Leoni III (717-741) vuri nën vartësinë e patriakut të Kostandinopojës edhe peshkopatën e Justiniana Primës<sup>14</sup>. Peshkopata e Shkupit na del përsëri në dritën e dokumentave të vitit 864, në të cilin prijësi bullgar, Borisi, u pagëzua si i krishterë në kishën e Ballshit së bashku me popullin e vet<sup>15</sup>. Në kohën e sundimit të perandorit Boris (852-889), i cili luhatej midis Romës dhe Konstandinopolit, perandori iu drejtua Konkilit VIII të Përgjithshëm në Kostandinopojë (869 - 870) në të cilën u vendos që Bullgaria të përfshihet në mbikqyrjen e Patriakanës së Kostandinopolit ku do të përfshihet dhe Dardania<sup>16</sup>.

Vetëm në shekullin e X dioqeza e Shkupit përmendet në mesin e dioqezave të tjera të perandorisë së gjërë të Samuelit. Kjo është hera e parë që pas vitit 602, që në burimet kishtarë përmendet *Eccelesia Scupina* e dikurshme.

<sup>12</sup> D. Cuhlev, Istorija na Blgarskata Crkva (864-1186), 128,171.

<sup>13</sup> E.Golubinskij, Kratkij očerk istorija Južnih Slovena, p, 52-61.

<sup>14</sup> D. Cuhlev, Istorija na Blgarskata Crkva ( 864-1186), 128,171.

<sup>15</sup> N.Ceka, Ilirët, Tiranë 2000, p.162.

<sup>16</sup> G. Gjini, Ipeshkvia .., p.79.

Gjatë shekujve IX-XI autoriteti bizantin veç bregdetit shtrihej edhe në thellësi të vendit. Më shumë se një përpjekje për të krijuar një lidhje tokësore me metropolet, kontrolli i rrugëve të vjetra romake nepër luginat e lumenjve lidhej me interesin për metalet, veçanërisht për ato të pjesës verilindore të Dardanisë. Dihet me siguri që në fillin të shekullit XI serbët shpesh herë sulmonin Zveçanin dhe Lipjanin dy qendra të fortifikuara<sup>17</sup>. Nga ana tjetër prezenca e vazhdueshme e popullsisë vendase përgjatë këtyre rrugëve provohet nga vendbanimet e rëndësishme arbërore të dëshmuara në Dollc Zym, Ponorc, Koshare, Kusarë, Zitza, Gjonaj, Vermicë, Zatriq<sup>18</sup> etj. Ky fakt duhet lidhur me kujdesin e administratës bizantine për të siguruar transportin e metaleve nga trevat e Dardanisë përmes luginave të Drinit. Komunikimet natyrore dhe kushtet e favorshme të jetesës në rajonin e Kosovës kanë ndihmuar që këto të jenë territore tërheqëse për vendbanime. Duke iu referuar materialit të publikuar më parë i cili vjen me origjinë nga ekspeditat survejuese në terren si dhe nga gërmimet arkeologjike mendojmë qendrat e periudhës së hershme mesjetare përfshijnë disa vendbanime të tipit qytezë të cilat janë me origjinë nga antikiteti i vonë ku në brendësi të tyre janë ndërtuar objekte kishtarë të shekujve IX-XI, siç mund të veçojmë qendrat në Prizren, Ujmirë, Dollc, Harillaq, Vlashnje, Pejë, Pecë<sup>19</sup>, etj., Kalimi nga strukturat e administratës *kishtarë* të fazës së parë (deri në fundin e shek. VI- fillimin e shek. VII) në atë të fazës së dytë, që dokumentohet në shek. IX - X sigurisht nuk duhet të jetë bërë menjëherë. Periudha e mesjetës së hershme është karakterizuar nga ndërtimi i disa kishave të vogla. Me i rëndësishëm akoma është fakti i vazhdimësisë kishtarë, e cila lidhet me qëndresën e komuniteteve të hershme të krishtera.

Sllavët e pranuan krishtërimin vetëm pas mesin e shek. IX, kur bullgarët u kthyen të krishterë me vendim të carit të tyre Boris, ndërkohë që popullsia shqiptare e Kosovës ishte plotësisht e formuar gjatë dyndjes së fundit bullgare të gjysmës së dytë të shek. IX.

<sup>17</sup> Kosovo nekade i danas, Beograd 1973

<sup>18</sup> L. Përzhita, G. Hoxha, Fortifikimet e shekujve IV-VI në Dardaninë Perëndimore, Tiranë 2003; L. Përzhita, G. Hoxha, *Rechercher sur les forteresses de la basse antiquité et du moyen age dans le basin de Drini i Bardhë*, Studia Albanica, Tiranë 2002, p 133-156.

<sup>19</sup> L. Përzhita, G. Hoxha, *Recherches sur les forteresses de la basse antiquité dans le territoires de Dardanie Occidentale, L'Ilyrie Méridionale et l'Epire dans l'antiquité IV*, Actes du IV Colloque International de Grenoble (10-12 octobre, 2002) Paris, p. 475, fig.10.

Siç vërehet nga kjo ekspozë e shkurtër, hulumtimet rreth shekujve të errët të mesjetës kanë nevojë për një thellim të mëtutjeshëm e më serioz në mënyrë që të sqarohen një sërë problemesh që lidhen me këtë fushë kaq të rëndësishme të historisë Ballkanike.

## BIBLIOGRAFIA

- A. BAĆKALLOV, *The Early Middle Ages*, The archeological treasures of Kosovo and Metohija, Beograd 1998, p. 376.
- D. CUHLEV, *Istorija na Blgarskata Crkva (864-1186) I*, Sofija 1911,128,171;
- E. HONIGMAN, *Recherches sur les listes des Pères de Nicés et de Constantinople*, Byzantion 11, 1936, p. 442
- E.GOLUBINJSKIJ, *Kratkij očerk istorija Južnih Slovena*, ZRVI 2, 1953 p, 52-61.
- F. PEJA, A. HAJDARI, *The fortress of Harilaq*, L'Ilyrie Méridionale et l'Epire dans l'antiquité V, Actes du IV Colloque International de Grenoble (10-12 octobre, 2008) volume II, Paris, p.479-482.
- G. GJINI, *Ipeshkvia Shkup – Prizren nëpër shekuj*, Zagreb 1992.
- G. HOXHA, *Mbi gërmimet arkeologjike në kishën palokristiane të fshatit Korishë (21 maj-12 qershor 2004*, Kosova Arkeologjike 1-2005, Prishtinë 2006, f. 167-173.
- KOSOVO NEKADE I DANAS, Beograd 1973
- L. PËRZHITA, G. HOXHA, *Recherches sur les forteresses de la basse antiquité dans le territoires de Dardanie Occidentale*, L'Ilyrie Méridionale et l'Epire dans l'antiquité IV, Actes du IV Colloque International de Grenoble (10-12 octobre, 2002) Paris, p. 475, fig.10.
- L. PËRZHITA, G.HOXHA, *Fortifikimet e shekujve IV-VI në Dardanië Perëndimore*, Tiranë 2003.
- L. PËRZHITA, G. HOXHA, *Rechercher sur les forteresses de la basse antiquite et du moyen age dans le basin de Drini i Bardhë*, Studia Albanica, Tiranë 2002, p 133-156.
- L. PËRZHITA, K. LUCI, G. HOXHA, A. BUNGRI, F. PEJA, T. KASTRATI, *Harta Arkeologjike e Kosovës I*, Prishtinë 2006.
- N. CEKA, *Ilirët*, Tiranë 2000, p.162.
- Z. MIRDITA, *Krishtenizmi nder shqiptaret*, Zagreb 1998;

## SUMMARY

### AN OVERVIEW ON ECCLESIASTICAL ORGANISATION IN DARDANIA

Recent years' investigations in Kosova have attested that the late antique centers are often presenting unique values for the urbanization of this territory, primarily during Justinian's rule and later during the Middle Ages. Several paleo-byzantine monuments, small towns or fortified settlements make up the basic structural remains of this period. Their study has just begun to draw up a new picture on our archeological knowledge as well as on early Christian architecture in Kosova. It is of a great importance to refer to previous discoveries and researches of paleochristian architecture remains as well as to the many new results achieved recently at Kosova. Recent archaeological excavation at Korishtë (Prizren), Harillaq (Fushë-Kosovë) and Kasterc (Suharekë) have not only ascertained the respective fortified systems but also produced a paleochristian church, ranking it within the 6th century sites in Dardania.

The construction of several religious buildings in the previously explored territory such as those of Vërmicë, Banja near Pejë, or traces of an apse discovered while constructing the modern road Pejë-Banjë, date back to the 4<sup>th</sup> – 5<sup>th</sup> centuries. The churches of Bela Cerkve and that of Studenica, constructed over preexisting structures, date back in the 6<sup>th</sup> century. Within this group can be further included the church of St. Angelus in Prizren, which however dated to the 10<sup>th</sup> century, the decorative and architectural elements suggests an early Christian original setting. The first written document that attests on the ecclesiastical organization in the province of Dardania is the first council, organized by Emperor Constantine in AD

325, mentioning the bishop's name of Dardania's metropolis. Nevertheless, a number of other sources indicate that dardanian territory had embraced much earlier the ideas of Christianity. One significant indication is the mention of dardanian martyrs, *Flori* and *Lauri*, in Dardania in the middle of the 2<sup>nd</sup> century AD, in *Acta Sanctorum* and *Ulpiana* as martyrdom place. It also turns out that in the Council of Nicaea was participating the dardanian bishop "Dacus Dardaniae". Another important center for the evolution of the Christian religion in Dardania, except Skopje, is *Ulpiana*, which is ranked as a bishopric center in the 4<sup>th</sup> century. The ecclesiastical organization of Dardania during the 4<sup>th</sup> and 5<sup>th</sup> centuries was based on dioceses such as *Skopje*, *Ulpiana*, *Neutina*, *Diokletiana*, *Mariana*, *Justiniana Prima*, *Stobi* etc. According the historical sources of the 6<sup>th</sup> century (552-559), major religious reaction fulminated in *Ulpiana*, due to the decree of "*Tria Capitula*". Such a 6<sup>th</sup> century phenomenon is related to the disagreement of the dardanian religious leaders to the decision of Pope Virgilius. This apparently expresses principally the establishment of religious stable structures in Dardanian and its important policy in the existing hierarchy, since as it is already known, they did not signed in the council of Pope Virgilius for the punishment of "*Tria Capitula*". But this document is of great importance since here are mentioned Dardania's Bishopric as well as Dardania's representatives as it is the case for the archbishop of Justiniana Prima, *Benenat*; *Sabin* from Zepara, the prophet of Naissus and the bishop of Justiniana Secunda, Paul and so on. At the same time, all the communications kept for the Dardanian Church such as those of Pope Celestine I, Innocent I (c.441), Gelasius I (c. 493), Simak (c. 513), Gregory the Great (c.592) as well as those of the emperors.

In the second novel CXXXI (c. 545) the dardanian emperor of Byzantine empire, emperor Justinian, fixed up the status of the archbishop and of the vicariate of Justiniana Prima. At the same time here is also recorded the correspondence of the dardanian bishops, particularly Emperor Leo I August, signed by Bishop Ursil, Dalmat and Maksim, as well as another correspondence addressed to Pope Gelasius, etc.

The conversion of population into Christian coincided with two great waves of barbarian invasions in the Western Balkan territory. The period between c.700-850 marks the beginning of the transformative processes in the East and West parts of the Empire. The first two centuries after the arrival of Slavs in the territory of Dardania are dark and full of uncertainty, not only for history but specifically for ecclesiastical circumstances.

During the 9<sup>th</sup> to 12<sup>th</sup> centuries the Slavs were settled in the Balkan and carried out the long process of their Christianization. The lack of historical sources produced difficulties in ascertaining the situation for this period as it is accompanied



by the lack of ecclesiastical data of the 9<sup>th</sup> century Bulgarian Empire. The inflow of the Slavs, undoubtedly destroyed the ecclesiastical life that had flourished until that time. For a certain period of time, all the connections to Rome as well as other coastal cities were braked of. Alternative evidence testify that Skopje mentained such connections as long as the end of the 7<sup>th</sup> century due to participation of a dardanian bishop in the 7<sup>th</sup> Ecumenical Council of c.787.

During the reign of Leo III, (717-741), the bishopric of Justiniana Prima depended on Constantinople. In 787, the bishops of Dardania participated in the Nicaea Council, while the Byzantine emperor Leo III (717-741) placed the bishopric of Justiniana Prima under the patriarch of Constantinople. The Archbishopric of Skopje appears once more in the documents of c.864, where the Bulgarian leader, Boris, was baptized as a Christian in Ballshi church together with his followers. This proves that the inhabitants of Southern Dardania were not Slavic. Furthermore, the bishopric of Skopje emerges in the documents of 864 as an important ecclesiastical center. At the time of Emperor Boris (852-889), hasitating between Rome and Constantinople, the emperor addressed the general 8<sup>th</sup> Council of Constantinople (869-870), where was agreed for Bulgaria to be included in the Patriarchate of Constantinople where Dardania will also be included. Only in the 10<sup>th</sup> century the diocese of Skopje is mentioned among other dioceses of the great empire of Samuel. Since AD 602 this is the first time that the former *Ecclesia Scupina* is mentioned.

During the 9<sup>th</sup> to 11<sup>th</sup> centuries the Byzantine authority extended not only in the coastal cities but also within the hinterland. The keeping under control of the old Roman roads across the river valleys more than an attempt to create a terrestrial connection to the metropolis was linked to the interest of metals, especially those of the northeastern part of Dardania. It is certainly known that in the beginning of the 11<sup>th</sup> century the Serbs assaulted the fortified sites of Zvečan and Lipjan quite often. On the other hand, the frequent presence of the local population along these roads is proved by the important arbërorian settlements established in Dollc Zym, Ponorc, Kosharë, Kusarë, Zitza, Gjonaj, Vermicë, Zatriq and others. This fact should be related to the Byzantine administration's cautiousness to ensure the transport of metals from Dardania along Drin valley. Terrestrial communications facilities as well as favorable living conditions in Kosova region have determined this area as very attractive for settlements. Referring to the previously published material produced by survey investigations and archaeological excavations, we assume that early medieval centers include several settlements originating from late antiquity within which churches of the 9<sup>th</sup> – 11<sup>th</sup> centuries are constructed, as it is the case for Prizren, Ujmirë, Dollc, Harillaq, Vlashnje, Pejë, Pecë, etc., The transition from the ecclesiastical administrative structures of the first phase (to the end of the 6<sup>th</sup> – 7<sup>th</sup>

centuries AD) to that of the second phase, documented in the 9<sup>th</sup> to 10<sup>th</sup> centuries, certainly achieved gradually. Early Middle Ages is characterized by the construction of several small churches. Most important is the ecclesiastical continuity, which is due to the survival of the early Christian communities.

The Slavs did accept Christianity only after the middle of the 9<sup>th</sup> century, when Bulgarians converted to Christian after the decision of their leader Boris, while the Albanian population of Kosova appears to have been fully adapted during the last Bulgarian occupation of the second half of the 9<sup>th</sup> century.

As it is argued in this discussion, the research of the dark age period needs further detailed and contextual investigations in order to ascertain a number of questions concerning this important field of the Balkan history.